



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

ALEANCA E GRAVE DEPUTETE

RAPORT

PËR VEPRIMTARINË E GRUPIT TË DEPUTETEVE “ALEANCA E GRAVE DEPUTETE” PËR PERIUDHËN JANAR – KORRIK 2021

I. ORGANIZIMI I ALEANCËS SË GRAVE DEPUTETE (AGD)

Aleanca e Grave Deputete është një organizim vullnetar i grave ligjvënese të të gjitha grupimeve politike në Kuvendin e Shqipërisë. Në vëmendje të saj është arritja e objektivit që synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në pushtetin vendor. Aleanca e Grave Deputete në fillim të Legjislaturës së IX përbëhej nga 41 gra deputete. Në përfundim të Legjislaturës së IX, Aleanca përbëhej nga 38 gra të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste, Grupi “Demokrat”, Grupi “I pavarur”, Grupi “Demokraci dhe drejtësi” dhe gra deputete të pavarura. *(Shtojca nr. 1)*

II. VEPRIMTARIA E AGD-SË GJATË VITIT 2021

Gjatë vitit 2021, Aleanca e Grave Deputete ka zhvilluar veprimtaritë e mëposhtme:

a) Pjesëmarrje në trajnime

Më datë 13.01.2021-14.01.2021, Aleanca e Grave Deputete e mbështetur nga programi MATRA i Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta (Hollandës), Instituti i Studimeve Politike dhe Kuvendi i Shqipërisë zhvilloi një trajnim dy ditor në fushën e komunikimit politik dhe marrëdhënieve publike në fushat elektorale. Trajnimi u zhvillua virtualisht nga ekspertet e njohura hollandeze, znj. Maud van de Wiel dhe znj. Julia Wouters, të cilat kanë mbështetur e trajnuar personalitete të njohura publike në Hollandë. Praktika të tilla në funksion të ngritjeve të kapaciteteve do të vijojnë në funksion të problematikave, nevojave dhe sfidave në përmbushjen e përgjegjësisë parlamentare, politike e publike të grave deputete të Kuvendit të Shqipërisë.

b) Pjesëmarrje në konferenca dhe takime

Më datë 19.05.2021, Aleanca e Grave Deputete mori pjesë në një takim online të organizuar nga Sekretariati i OSBE-së për Programin për Çështje Gjinore, ODIHR dhe Asambleja Parlamentare e OSBE-së. Takimi do të ketë në fokus të tij temën : “*Ligj bërja e bazuar në prova për të luftuar dhe parandaluar dhunën ndaj grave*”. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte diskutimi për mënyrën se si të zhvillohen ligje më të mira dhe më efikase që mbrojnë gratë dhe vajzat nga të gjitha format e dhunës.

Më datë 14.06.2021, Aleanca e Grave Deputete mori pjesë në “Konferenca e grave parlamentare të vendeve të rajonit”. Konferenca e këtij viti u organizua nga Misioni i OSBE-së në Mal të Zi në bashkëpunim të ngushtë me ODIHR dhe Parlamentin malazez. Tema e konferencës së këtij viti ishte “Roli i parlamenteve në promovimin e pjesëmarrjes politike të grave” me një seancë hapëse mbi Dhunën ndaj Grave në Politikë. Konferenca u nda në tre sesione ku u trajtuan temat vijuese:

- *Legjislacioni dhe Parlamentet e Ndjeshme Gjimore: Praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra;*
- *Dhuna ndaj Grave në Politikë: Roli i Parlamenteve;*
- *Të punojmë së bashku për barazinë gjimore dhe gratë në politikë: Bashkëpunimi dhe Rrjetëzimi ndërinstytucional.*

Më datë 14.07.2021, Aleanca e Grave Deputete mori pjesë në një konferencë online të organizuar nga Forumi Evropian Liberal, programi rajonal i NDI-së i financuar nga National Endowment for Democracy (NED), Qendra Suedeze e Palme dhe Qendra Ndërkombëtare Kroate e Arsimit. Tema e konferencës ishte “*Breaking the Cycle-Gender Based Violence in Public Space*”.

c) Pjesëmarrje në veprimtari të tjera

Më datë 26.01.2021, Aleanca e Grave Deputete dhe Nënkomisioni Parlamentar për Barazinë Gjimore në bashkëpunim me Rrjetin e Grave Barazi në Vendimmarrje, Institutin Kombëtar Demokratik, me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, zhvilluan ceremoninë e mbylljes së “Akademisë së Parë të Lidërsip-it - Executive Masterclass , Legjislatura 2017 – 2021”. Ceremonia u përshëndet nga Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Yuri Kim e cila në fjalën e saj përmes të tjerave tha : “Pjesëmarrja dhe fuqizimi i grave në të gjitha nivelet e shoqërisë është çelësi për të çuar demokracitë përpara. Megjithatë, ndërsa pjesëmarrja e barabartë e grave është thelbësore, pjesëmarrja nuk është qëllimi. Qëllimi është ndërtimi i një shoqërie më të përparuar dhe e bazuar në merita, ku kontributet dhe përfitimet ndahen në mënyrë të barabartë”. Gjithashtu, ceremonia u përshëndet nga znj. Elona Gjebrea Hoxha, nënkryetare e Aleancës së Grave Deputete, znj. Vasilika Hysi, nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë dhe znj. Eglantina Gjermani, Kryetare e Nënkomisionit Parlamentar për Barazinë Gjimore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas.

Akademia e Lidërsip-it është krijuar me vizionin për të qenë një forcë shtytëse e ndryshimit duke mbështetur gratë parlamentare në organet ligjvënëse për të rritur kapacitetet dhe aftësitë e tyre drejtuese për të përfaqësuar në mënyrë sa më efektive. Në përfundim të ceremonisë, u shpërndanë certifikata për pjesëmarrëset në Akademinë e Lidërsip-it”.

Akademia e Lidërsip-it për Legjislaturën 2017 -2021 ka zhvilluar sesione teorike dhe praktike për gratë parlamentare në tema si: Komunikimi dhe e folura në publik; Lidërsip-i dhe jeta publike;

Përshatja e punës parlamentare dhe komunikimi publik gjatë periudhës së pandemisë Covid-19; Strategjitë politike për gratë kandidate në sistemet zgjedhore me lista të hapura; Qasja e grave në financat e partive politike dhe ngritja e fondeve për fushatat zgjedhore.

Përmes mbështetjes së trajnerëve me përvojë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropa Perëndimore, të ftuar për të ndarë njohuritë, përvojat, mësimet e marra dhe strategjitë nga puna e tyre me gratë parlamentare, u zhvillua një Akademi e Leadership-it bazuar në tema dhe module të konsideruara si çelësi i suksesit të grave parlamentare në punën e tyre.

Më datë 1.07.2021- 02.07.2021, Aleanca e Grave Deputete dhe Nënkomisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave zhvilluan një takim përmbyllës për Legjislaturën e IX. Gjatë këtij takimi znj. Elona Gjebrea Hoxha, Nënkryetare e Aleancës së Grave Deputete dhe znj. Eglantina Gjermeni, Kryetare e Nënkomisionit Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave prezantuan një përmbledhje të aktiviteteve të zhvilluara gjatë Legjislaturës së kaluar dhe mësimet e nxjerra prej saj. Në prezantimin e tyre ato vlerësuan dhe falënderuan të gjitha gratë deputete për angazhimin, kontributin dhe bashkëpunimin e tyre me Aleancën dhe Nënkomisionin. Më tej, ato theksuan që në të ardhmen duhet të ketë një fuqizim të rolit të Aleancës dhe Nënkomisionit për barazinë gjinore.

Vëmendje e veçantë iu kushtua diskutimit të Programit për një Parlament të Ndjeshëm Gjinor si një histori suksesi për gratë deputete për promovimin e barazisë gjinore. Programi përbën një dokument strategjik kuadër për përmirësimin e ndjeshmërisë gjinore në Kuvendin e Shqipërisë.

Në përfundim të takimit u prezantuan edhe hapat e mëtejshme dhe praktikatat më të mira për legjislaturën e re. Takimi u përshëndet dhe nga Nënkryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi e cila vlerësoi punën dhe rolin e Aleancës gjatë Legjislaturës së IX.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri”, mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Shtojca 1

1. Adelina Rista
2. Almira Xhembulla
3. Antoneta Dhima
4. Amra Barova
5. Ardiana Jaku
6. Artemis Malo
7. Aurora Mara
8. Blerina Gjylameti
9. Ediola Braha
10. Edlira Bode
11. Edlira Hyseni
12. Eglantina Gjermeni
13. Elda Hoti
14. Elena Xhina
15. Elona Hoxha
16. Elisa Spiropali
17. Enada Kapllani
18. Ermonela Valikaj (Felaj)
19. Evis Kushi
20. Fatjona Dhimitri
21. Klodiana Spahiu
22. Klotilda Bushka (Ferhati)
23. Lindita Nikolla
24. Majlinda Halilaj
25. Milva Ekonomi
26. Mimi Kodheli
27. Mirela Kumbaro (Furxhi)
28. Ogerta Manastirliu
29. Olta Xhaçka
30. Reme Lala
31. Rudina Hajdari
32. Senida Mesi
33. Suzana Topi
34. Tatiana Piro (Nurçe)
35. Vasilika Hysi
36. Vilma Bello
37. Gentiana Cakrani
38. Jetmira Rraboshta